



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/31

Prishtinë, më 6 nëntor 2003, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për inspektoratin sanitar-nr.2003/24;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuara-nr2003/32 dhe
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 13 nëntor 2003.

Në fillim të seancës, deputeti Fatmir Rexhepi i informoi të pranishmit se ishte realizuar vendimi i Kuvendit të Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare komunave të

Gjilanit,Dardanës dhe të Vitisë,për sanimin e pasojave që la pas tërmeti që kishte goditur,dy vjet më parë, këtë rajon.

1.Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës të mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për inspektoratin sanitar-nr.2003/28.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji, si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional.

Ai i hodhi në votë,veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi dhe të deputetëve Svetomir Samarxhiq dhe Cveta Bujiq.

Kuvendi,me shumicë votash, **i miratoi** këto

amendamente:1,2,3,4,5,6,7,8,10a,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,23,24a,26a,27,28a,29,32,33,35.36a,37,38,39,41,42,43a,45,47,48,49,50,51,53a,54,56,59,60,61,62,63a,64,65,66,67,68 dhe 69,kurse **nuk i miratoi**

amendamentet:9,10b,21,22,24b,25,26b,28b,30,31,34,36b,40,43b,44,46,52,53b,55,57,58 dhe 63b.

Pastaj,kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----18;

Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës,me shumicë votash, e miratoi Ligjin për inspektoratin sanitar.

U dha një pauzë prej 15 minutash.

Pas puzës seancën e krysoi **Fatmir Sejdiu**,anëtar i Kryesisë.

3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar-nr.2003/23.

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurën e shqyrtimit të këtij p/ligji,si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional.

Ai i hodhi në votë,veç e veç,amendamentet e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale,të Komisionit Legjislativ,të Grupit Parlamentar “Kthimi”,të deputetes Nafije Berisha dhe të deputetit Ismajl Kurteshi.

Kuvendi, me shumicë votash, **i miratoi** këto **amendamente**: 1a, 2, 4, 5a, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 18, 19, 20, 21, 22, 23a, 24a, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 34, 35, 36, 37a, 38a, 40, 41, 42 dhe 43a, kurse **nuk i miratoi amendamentet**: 1b, 3, 5b, 9, 14, 15, 16, 17, 23b, 24b, 25, 30, 32, 33, 37b, 38b, 39 dhe 43b.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votë P/lgjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----0;
Abstenime----- 16.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

Arsim Bajrami, në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, shprehu pakënaqësi lidhur me procedurën e votimit të këtij ligji.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 13 nëntor 2003.

Kuvendi, me propozim të Kryesisë, e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të datës 13 nëntor 2003, si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për shëndetësi-nr.2003/31;
2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorve dhe
3. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:00

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik **Nexhat DACI**